



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË PËR KOMUNITETE DHE KTHIM PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Vlera e pasurisë kapitale e prezantuar në PFV ishte mbivlerësuar për 954,797€ si rezultat i regjistrimit të gabuar dhe mos bartjes së pasurisë te përfituesit;
- B2 MKK gjatë vitit 2024 kishte realizuar pagesa në vlerë prej 112,558€ për 19 punonjës për të cilët nuk kishte dëshmi të vijueshmërisë në punë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Në kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MKK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri për Komunitete dhe Kthim është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë më shumë fokus kanë të bëjnë me menaxhimin e pasurive për shkak të mbivlerësimit të tyre si dhe mangësive në procesin e inventarizimit/vlerësimit të pasurive jo financiare. Në kontekst të shpenzimeve, kërkohet fokus me pagesat e zyrtarëve sipas Marrëveshjes së Brukselit në mungesë të evidencave për vajtje-ardhje në punë.

Ky raport ka rezultuar me tre (3) rekomandime, të gjitha janë të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mbivlerësimi i pasurisë kapitale

Gjetja

Neni 12 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton mënyrën e regjistrimit, kategorizimit dhe kalimit të pronësisë me rastin e blerjes apo ndërtimit të pasurisë përmes bashkëfinancimit. Tutje, neni 13 i kësaj rregullore përcakton se "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Më tej, sipas nenit 6.1 'Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj.

Vlera e prezantuar e pasurisë kapitale dhe jo kapitale në PFV ishte mbivlerësuar për 954,797€, si rezultat i mos bartjes së pasurive te pala përfituese dhe kategorizimit jo të drejtë.

Çështjet që kanë ndikuar këtë gjendje janë shpalosur, si në vijim:

- Për projektin "Kthimi dhe ri-integrimi në Kosovë" EU-RRK faza e V, një (1) transaksion i testuar në vlerë prej 500,000€, figuron në regjistrin e Ministrisë e klasifikuar si investim në vijim, përderisa për fazën e V-të projekti është i përfunduar. Më tej, në pëputhje me planin kontabël ky projekt ka kaluar tek kategoria e subvencioneve nga viti 2025. Andaj, për vitin 2024 regjistri i pasurive kapitale ishte mbivlerësuar për të njëjtën shumë;
- Regjistri i pasurive ishte i mbivlerësuar edhe për vlerën prej 214,750€ që kishte të bënte me furnizimin me material ndërtimor për përfitues individual, e cila ishte e regjistruar si investim në vijim, përderisa ky shpenzim për nga natyra i takonin kategorisë subvencione dhe transfere dhe nuk i plotëson kriteret e shpenzimit kapital;

- Për projektin "'Ndërtimi i sallës sportive' në fshatin Biti e lartë - Komuna e Shtërpçës, dy (2) transaksione të testuara në vlerë totale prej 108,968€ ishin klasifikuar si investim në vijim, ndërsa pranimi teknik i projektit ishte bërë më 23.10.2023. Nuk ishte bërë bartja te pala përfituese, me ç'rast regjistrat ishin mbivlerësuar për të njëjtën shumë;
- Për projektin "Ndërtimi i sallës pranë kishës Sveti Nikolla' në fshatin Banjskë - Komuna e Vushtrisë, dy (2) transaksione të testuara në vlerë prej 48,691€ ishin klasifikuar si investim në vijim, ndërsa pranimi teknik i projektit ishte bërë më 31.08.2023. Nuk ishte bërë bartja te pala përfituese, me ç'rast regjistrat ishin mbivlerësuar për të njëjtën shumë;
- Për projektin "Renovimi i shtëpisë Marija Novakovic" dy (2) transaksione të testuara në vlerë prej 4,175€ ishin klasifikuar si investim në vijim, ndërsa pranimi teknik i projektit ishte bërë më 06.05.2022. Nuk ishte bërë bartja te pala përfituese, me ç'rast regjistrat ishin mbivlerësuar për të njëjtën shumë;
- Për projektin "Mbështetje për zgjidhje të qëndrueshme për banorët e qendrave kolektive në Kosovë" një transaksion në vlerë prej 78,213€ ishte regjistruar si pasuri në SIMFK. Pagesat kishin të bënin me pagesën e qirasë dhe mbështetje teknike. Rrjedhimisht, regjistri i pasurisë ishte mbivlerësuar për këtë vlerë.

Përkundër që ministria kishte ndërmarr disa veprime duke bërë disa kërkesa në Thesar për të bërë korrigjimet e këtyre çështjeve (shumica ishin të trajtuara edhe në raportin e auditimit për vitin 2023), mbivlerësimi i regjistrave të pasurisë dhe mangësitë e identifikuara ishin si rezultat i mungesës së veprimeve të mjaftueshme si dhe funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në këtë fushë.

Ndikimi

Mos bartja e pronësisë së pasurive tek përfituesit si dhe regjistrimi i pasurisë e cila nuk i plotëson kriteret për kapitalizim ndikon në paraqitje jo të drejtë dhe mbivlerësim të vlerës së pasurisë në PFV.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masat e duhura për të siguruar bartjen e plotë të pronësisë së pasurisë tek komunat dhe njëkohësisht të bëjë azhurnimin e regjistrat të pasurisë duke i larguar investimet në vijim të cilat tashmë i takojnë përfituesve tjerë, po ashtu të largoj nga regjistrat e pasurisë shpenzimet që nuk i plotësojnë kriteret e shpenzimeve kapitale në mënyrë që pasuritë të prezantohen drejt dhe saktë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Kompensimi i punonjësve pa vijueshmëri të plotë në punë

Gjetja Neni 9 i Rregullores (QRK) Nr.107/2022 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve, përcakton se "Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni ". Po ashtu, neni 17.2 i Rregullores së re (QRK) Nr.04/2024 Për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik, përcakton se "Vijueshmëria në punë e zyrtarit publik evidentohet përmes regjistrimit në sistemin elektronik që administrohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale." Tutje, neni 17.3 përcakton se "Kur nuk është e mundur për arsye teknike, vijueshmëria në punë e zyrtarit publik bëhet përmes regjistrimit në librat evidentues".

Me vendimin nr. 06/39 të datës 22.07.2015, Ministria ishte e obliguar ti sistemoj 19 punonjës të komunitetit serb me qëllim të integritetit të tyre në sistemin e Republikës së Kosovës. Sipas konfirmimeve nga zyrtarët relevant, për të njëjtit nuk kishte dëshmi të vijueshmërisë në punë. Shpenzimi për vitin 2024 për këtë kategori ishte 112,558€.

Kjo dukuri po vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse është raportuar në vazhdimësi nga raportet tona të auditimit. Për vitin 2025, ministria kishte filluar të mbajë evidencat për vijueshmërinë në punë, çështje kjo e cila do të vlerësohet me procedurat audituese të vitit 2025.

Ndikimi Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmive për vijueshmëri në punë dhe në mungesë të angazhimit për kryerjen e detyrave zyrtare, konsiderohen si pagesa të pa arsyetuara dhe dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të analizoj situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhje, dhe të ndërmerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e pasurive kapitale e paraqitur në PFV është 2,742,126€, e pasurive jokapitale është 31,812€ si dhe e stoqeve 11,337€.

Çështja B3 - Mangësi në procesin e inventarizimit/vlerësimit të pasurive

Gjetja

Neni 19.4.3 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton se çdo fund vit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Ministria kishte bërë inventarizimin e pasurisë për vitin 2024, por raporti i inventarizimit nuk është harmonizuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë. Rrjedhimisht, nuk dihet diferenca mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu, nuk ishte kryer vlerësimi i pasurive jo financiare sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos ndërmarrjes së masave të mjaftueshme në pajtim me kërkesat e rregullores që ndërlidhen me detyrat e komisionit të inventarizimit/vlerësimit.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar pamundësojnë krahasimin e rezultateve dhe ndikojnë në identifikimin e pasurive të cilat nuk janë në pronësi të MKK-se dhe pasurive që duhet të largohen nga regjistrat duke mundësuar azhurnimin e regjistrit me informata të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim.

Rekomandimi B3

Ministri duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë ka informata të plota për të gjithë pasuritë në përdorim dhe në pronësi të ministrisë, dhe pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive, në mënyrë që prezantimi i pasurive në PFV të jetë i saktë. Po ashtu të sigurojë se bëhet vlerësimi i pasurive jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	6,639,659	7,040,324	6,492,434	5,479,908	2,871,886
Grante Qeveritare - Buxheti	6,639,659	7,040,324	6,492,434	5,479,908	2,871,886
Donacionet e jashtme	0	0	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 400,665€. Kjo rritje është si rezultat i ndarjeve të reja dhe shkurtimeve buxhetore me vendime qeveritare.

Në vitin 2024 MKK ka shpenzuar 92% të buxhetit përfundimtar në 2024 ose 6,492,434€, me një përmirësim prej 18% në krahasim me vitin paraprak. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	6,639,659	7,040,324	6,492,434	5,479,908	2,871,886
Pagat dhe mëditjet	948,398	882,397	882,397	828,625	700,827
Mallrat dhe shërbimet	374,261	324,261	223,061	222,503	201,869
Komunalitë	17,000	7,000	3,487	4,089	3,940
Subvencionet dhe transferet	2,100,000	4,016,666	3,967,337	3,276,810	62,924
Investimet Kapitale	3,200,000	1,810,000	1,416,152	1,147,880	1,902,326

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike të buxhetit janë dhënë më poshtë:


Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 66,001€ si rezultat i vendimit të Qeverisë për kursime. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 100%.

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 60,000€. Ky ndryshim ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime. Realizimi i buxhetit final ishte 68%.

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 1,916,666€ si rezultat i ndarjeve buxhetore me vendim të Qeverisë. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 98%.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,390,000€. Ky ndryshim ishte rezultat i vendimeve Qeveritare për kursime dhe transferim në kategorinë e subvencioneve. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 78%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga MKK në 2024 ishin në vlerë 5,790. Ato kishin të bënin me të hyrat nga kompensimet e dëmeve nga kompanitë e sigurimeve si dhe të hyrat e bartura nga viti paraprak.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti filleshtar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	5,790	11,645	
Të hyrat jo tatimore	0	0	3,231	11,645	
Të hyrat tjera	0	0	2,558		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV të vitit 2024 ka rezultuar me 5 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, dy (2) rekomandime ishin zbatuar si dhe tre (3) rekomandime të tjera nuk ishin zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masat e duhura për të siguruar bartjen e plotë të pronësisë së pasurisë tek komunat dhe njëkohësisht të bëjë azhurnimin e regjistrit të pasurisë duke i larguar investimet në vijim të cilat tashmë i takojnë përfituesve tjerë, po ashtu të largoj nga regjistrat e pasurisë shpenzimet operative në mënyrë që pasuritë të prezantohen drejt dhe saktë në PFV e vitit 2023. Për më tepër, të siguroj se aplikohet një analizë e mirëfilltë e regjistrit të pasurive, në mënyrë që saldo e bartur në vitin vijues të ofrojë informata të sakta.	Nuk ishin ndërmarrë veprime të mjaftueshme korrigjuese, prandaj edhe gjatë vitit 2024 kemi evidentuar raste të ngjashme të cilat janë reflektuar tek gjetja.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	Edhe gjatë vitit aktual është gjendje e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme nga zyrtarët përgjegjës në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	Nuk kemi hasur keqklasifikime të shpenzimeve për vitin 2024.	I zbatuar
4.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë se bëhet një planifikim më real i projekteve duke marrë për bazë ndër tjerash edhe rrethanat që mund të ndikojnë në realizimin e tyre. Po ashtu, në rastet kur ka ngecje në realizimin e projektit të ndërrmerren veprime parandaluese në pajtim me kontratën dhe ligjin.	Nuk kemi evidentuar mangësi të tilla gjatë vitit aktual.	I zbatuar
5.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë ka informata të plota për të gjithë pasuritë në përdorim dhe në pronësi të ministrisë, dhe pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive, në mënyrë që prezantimi i pasurive në PFV-të e vitit 2024 të jetë i saktë.	Sfida lidhur me inventarizimin dhe harmonizimin e regjistrave të pasurisë e kishin përcjellë ministrinë edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Ylber Sadiku, Udhëheqës i ekipit



Refiqe Morina, Anëtare e ekipit



Hysen Restelica, Anëtar i ekipit



Lumturije Sopi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Letër konfirmimi

 MINISTRIA PËR KOMUNITETET DHE KTHIM MINISTRIA FOR COMMUNITIES AND KTHIM MINISTRIUM FÜR GEMEINSCHAFTEN UND KTHIM				 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE	
Nr. Dokumenti: 1658 Data: 27.05.2025		Nr. Dokumenti: 27-05-2025		Nr. Dokumenti: 27-05-2025	
Nr. Org. / Jed. / Org. Unit: 03		Shif. Klasif. / Klasif. Kod / Class. Code: 47		Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: 799	
Nr. Stranica / Br. Stranica / No. Pages: 1		Nr. Stranica / Br. Stranica / No. Pages: 1		Nr. Stranica / Br. Stranica / No. Pages: 1	

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria për Komunitete dhe Kthim / Ministarstvo za Zajednice i Povratka /
Ministry for Communities and

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Nenad Rasic

Ministria për Komunitete dhe Kthim,

Data: 26.05.2025

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.